



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë




Fondi i Grave të Kosovës

Të drejtat e Grave janë të Drejtat e Njeriut

Grante të Vogla, Ndryshime të mëdha

2016-2017



© Rrjeti i Grave të Kosovës, dhjetor 2017

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Ky publikim mund të kopjohet dhe të shpërndahet në tërësi apo pjesërisht, duke cituar autorët.

Ky publikim është publikuar me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është vetëm përgjegjësi e Rrjetit të Grave të Kosovës dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyron qëndrimin zyrtar të Bashkimit Evropian.

Printuar në letër të riciklueshme nga Night Design në Prishtinë.

www.womensnetwork.org

Contents

Hyrje.....	4
Një Histori e Shkurtër për Fondin e Grave të Kosovës	5
Si funksionon Fondi i Grave të Kosovës?	10
Më shumë se vetëm një grant.....	12
FUQIZIMI I GRAVE PËR PJESËMARRJE NË POLITIKË DHE VENDIMMA-RRJE	14
Gratë në Dragash pjesë e proceseve politike.....	15
Liria dhe Legjenda avokojnë për përfshirje të BPGJ-së.....	17
Gratë e verbëra avokojnë	19
për më shumë mundësi	19
Trupi Koordinues Ndër-Komunal dhe Ndëretnik Promovon Pjesëmarrjen e Grave në Politike.....	21
Gratë shqiptare dhe serbe mësojnë teknika të avokimit.....	23
MBROJTJA E TË MBIJETUARA-VEDHE E DREJTA E GRAVE PËR NJË JETË PA DHUNË.....	25
Bashkëpunim i ri mes #EcShlirë dhe Policisë së Kosovës.....	26
“Psikoterapetutet në Veprim” ofron mbështetje për të mbijetuarat e dhunës seksuale	28
Aktivistet mbështesin të mbijetuarat e dhunës seksuale për realizuar të drejtat e tyre	30
MBROJTJA E TË DREJTAVE TË GRAVE PËR QASJE NË KUJDES CILËSOR SHËNDETËSOR.....	33
“Aksioni për Nëna dhe Fëmijë” vetëdijeson gratë për depressionin e pas-lindjes	34

Të rinjët informohen për shëndetin përmes artit.....	37
Instituti “Alfa” mbron të drejtat e grave të burgosura	40
Gratë në Prizren përfitojnë kontrole pa pagesë	42
ShEPF angazhohet që gratë të gëzojnë shëndet të mirë	44
Kujdes shëndetësor më i përshtatshëm për gra dhe vajza me aftësi të kufizuara.....	46
ShVPD mbështet personat e verbër dhe me të pamurit të dobësuar	48
AVANCIMI I TË DREJTAVE TË GRAVE PËR QASJE NË BURIME DHE FUQIZIMI EKONOMIK I TYRE	50
Gratë në Malishevë përfitojnë subvencione nga MBPZhR	51
“Education Code” përkrah gratë sipërmarrëse.....	53
Gratë me aftësi të kufizuara dhe lufta e tyre për të drejta të barabarta pronësore.....	55
Partners Kosova avokon për të drejtat e grave në pronë dhe trashëgimi.....	58
Përmirësimi i barazisë gjinore përmes transparencës institucionale	61
QKZHIM ndihmon të rinjtë e Gjakovës për punësim	63

Hyrje

Nga fillimi i vitit 2016 deri në përfundim të vitit 2017, Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) ka ndarë 22 grante për 26 organizata përmes Fondit të Grave të Kosovës (FGK), që arrijnë vlerën prej 103,503€.

Këto iniciativa u mundësuan falë mbështetjes së Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë përmes Instrumentit Evropian për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut si pjesë e Veprimit më të gjerë të RrGK-së për të forcuar rolin e organizatave të grave të shoqërisë civile në promovimin e të drejtave të njeriut të grave dhe pjesëmarrjes politike në Kosovë.

Nga këto iniciativa kanë **përfutur 3,380 persona nga vise të ndryshme të Kosovës** (86% gra dhe 14% burra) duke përfshirë persona me aftësi të kufizuara (7%), nga zonat rurale (42%), të etnive të ndryshme (13%) (p.sh., turke, gorane, serbe, rome, ashkallike, egjiptiane, boshnjake dhe shqiptare) dhe vajza (30%). Nga ky numër, **376 gra kanë marrë pjesë në procese vendimmarrëse** gjatë **89 iniciativave avokuese** të realizuara. Projekti ka luajtur rol të rëndësishëm për tu mundësuar grave dhe vajzave të zhvillojnë aftësi për avokim dhe të marrin pjesë më shumë në procese të ndryshme që ndikojnë në jetën e tyre brenda komuniteteve.

Ndërkohë, gratë dhe vajzat e pambrojtura dhe të marginalizuara, me ndihmën e organizatave për të drejtat e grave, kanë arritur të fitojnë njohuri dhe informata për të drejtat e tyre duke u fuqizuar për të ndërmarrë hapa drejt realizimit dhe mbrojtjes të këtyre të drejtave.

Andaj, këto grante të vogla të shpërndara nga Fondi i Grave të Kosovës kanë arritur ndryshime të mëdha drejt avancimit të të drejtave të grave si të drejta të njeriut. Disa iniciativa kanë kontribuar në zbatimin e Planit II të BE-së për Barazi Gjinore duke përmirësuar qasjen e grave në shëndetësi, arsimit, burime të ndryshme (si, tokë dhe tregëti), qeverisje dhe procese të politikave dhe për një jetë pa dhunë.

Sidoqoftë, ky projekt ka mbështetur grupet e të drejtave të grave në avancimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave dhe vajzave, veçanërisht në nivel lokal. Kjo broshurë tregon disa nga rrefimet e tyre.

Një Histori e Shkurtër për Fondin e Grave të Kosovës

Literatura, materialet, raportet e shumta, të cilat dita ditës po shtohen, më së miri tregojnë rëndësinë e mbështetjes së organizatave për të drejtave të grave si nxitës kryesor për ndryshime të qëndrueshme sociale dhe politike.¹ Grupet e të drejtave të grave janë të vendosura mjaft mirë për të ndërmarrë iniciativa shumë efikase dhe efektive drejt barazisë gjinore dhe të drejtave të grave brenda komuniteteve të tyre, veçanërisht në nivel komunal dhe lokal. Ato luajnë rol vendimtar në avancimin e të drejtave të grave si të drejta të njeriut, duke transformuar normat gjinore, duke luftuar dhunën në baza gjinore, duke vetëdijesuar publikun, duke ofruar shërbime për grupet e marginalizuara (sidomos në mungesë të shërbimeve shtetërore) dhe duke i mbajtur qeveritë përgjegjëse nëpërmjet avokimit

Për më tepër, në kontekstin e proceseve të anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE), grupet e të drejtave të grave mund të luajnë rol të rëndësishëm në mbështetjen, monitorimin dhe avokimin për zbatimin e reformave. Në të vërtetë, Këshilli Evropian (KE) ka deklaruar se "organizatat e grave janë partnerë vendimtar të BE-së" dhe inkurajoi mbështetjen për organizatat e të drejtave të grave.² Këshilli Evropian dhe Shërbimi Evropian i Veprimit të Jashtëm

¹ Për shembull, shih botimet e Shoqata e Grave për Zhvillim (AWID).

² Konkluzionet e Këshillit Evropian mbi Gjininë në Zhvillim, dokumenti 9241/15, 26 maj 2015, në: <http://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-9242-2015-INIT/en/pdf> dhe është cituar në Dokumentin e përbashkët punues të stafit të KE-së 'Barazia gjinore

(EEAS) kanë miratuar *Dokumentin Punues të Përbashkët të Stafit - Barazia Gjinore dhe Fuqizimi i Grave: Transformimi i Jetës së Vajzave dhe Grave përmes Marrëdhënieve të Jashtme të BE-së 2016-2020*,³ i njohur edhe si "Plani i Veprimeve Gjinor" (GAP II), i cili parasheh financim dhe mbështetje për organizatat e grave dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut.

Përkundër kontributeve të tyre të rëndësishme brenda komuniteteve, grupet lokale të të drejtave të grave shpesh kanë luftuar për të pasur qasje në burime që mbështesin punën e tyre të vlefshme. Fondi i Grave të Kosovës i RrGK-së u krijua fillimisht për të adresuar nevojën emergjente për të mbështetur organizatat e vogla të grave. Në kohën kur u krijua Fondi në vitin 2012, prioritetet e ndihmës së donatorëve dhe zvogëlimi i buxheteve për vendet e Ballkanit Perëndimor çuan në mbylljen e disa programeve të donatorëve për dhënie grantesh në Kosovë ose në zvogëlimin e fondeve për organizatat joqeveritare. Ndërkohë që disa donatorë mbetën, si BE, ata synonin të japin grante shumë të mëdha, të cilat ishin jashtëzakonisht të vështira për t'u qasur nga shumica e organizatave vendore. Grupet e grave me aftësi të limituara në gjuhën angleze dhe qarkullim minimal vjetor kanë luftuar për të marrë fonde të tilla.

Si rrjet i organizatave të grave, RrGK vazhdimisht ka pranuar kërkesa nga organizatat e saj anëtare për të hetuar mundësitë për adresimin e kësaj situatë dhe mbështetjen në punën e tyre të rëndësishme. Për të adresuar më mirë nevojat e tyre, RrGK realizoi një hulumtim në bashkëpunim të ngushtë me Shoqatën e Grave për Zhvillim (AWID), të titulluar *Ku janë paratë për të drejtat e grave: rast studimi për Kosovën*.⁴ Duke u nisur nga studimi i 90

dhe fuqizimi i gruas: Transformimi i Jetës së Vajzave dhe Grave nëpërmjet Marrëdhënieve të Jashtme të BE-së 2016-2020', SWD(2015) 182, Bruksel: 21 shtator 2015, f. 11.

³ Po aty.

⁴ RrGK dhe Alterhabitus, *Ku janë paratë për të drejtat e grave*, Prishtinë: RrGK, 2013, në:

<http://www.womensnetwork.org/documents/20140109133636147.pdf>

organizatave të grave dhe intervistave me 40 donatorë që veprojnë në Kosovë, ky raport ka shqyrtuar nga afër prijet, mundësitë dhe sfidat e financimit të grupeve të të drejtave të grave në Kosovë. Ky publikim ishte themelor për të kuptuar më mirë nevojat e grupeve të ndryshme të të drejtave të grave dhe njëkohësisht baza e themelimit të Fondit të Grave të Kosovës.

Ndërkohë, RrGK nxiti një proces shumë konsultativ, duke organizuar një sërë takimesh me organizatat e saj anëtare për të diskutuar nevojat dhe vizionin e tyre për themelimin e Fondit të Grave të Kosovës: cilat lloje të organizatave do të ishin prioritet për financim; cilat lloje iniciativash do të financoheshin; si do të funksiononin proceset e aplikimit; kush do të vendoste për financim; sa do të ishte shuma e grantit; dhe sa do të zgjaste financimi? Anëtarët e RrGK diskutuan dhe vendosën që Fondi i Grave të Kosovës duhet t'i japë prioritet financimit për organizatat e grave që:

- U mungon qasja në mundësitë tjera të financimit;
- Udhëhiqeshin dhe/ose kishin si përfitues kryesor grupet më të rrezikuara, duke përfshirë gratë e reja, gratë me aftësi të kufizuara, gratë në zonat rurale dhe nga grupet etnike minoritare; dhe
- Ndërmerrin iniciativa drejt zbatimit të Strategjisë së RrGK-së,⁵ e hartuar nga anëtarët e RrGK-së dhe duke shërbyer si një strategji e gjerë për lëvizjen e grave në Kosovë, drejt ndikimit në adresimin e nevojave të identifikuara.

Në procesin e themelimit të Fondit të Grave të Kosovës, RrGK shqyrtoi gjithashtu përvojat e fondacioneve të tjera që mbështesin grupet e shoqërisë civile në të gjithë botën dhe morën udhëzime nga Fondi i Rindërtimit i Grave në Serbi.

Fondi i Grave të Kosovës fillimisht mori mbështetje nga Fondacioni Kvinna till Kvinna në vitin 2012. Agjencia Austriake për

⁵ Shih: <http://www.womensnetwork.org/?message=true&FaqlID=5>

Zhvillim (ADA) filloi mbështetjen e Fondit në vitin 2013. Që nga viti 2015, Fondi i Grave të Kosovës ka marrë mbështetje nga Zyra e BE-së në Kosovë përmes Fondit për Shoqëri Civile (2015-2016) dhe Instrumenti Evropian për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut (2016-2017). Fondi gjithashtu ka marrë mbështetje nga Fondacioni IPKO dhe UN Women.

Fondi i Grave të Kosovës qw nga themelimi e deri nw dhjetor tw vitit 2017, ka dhënë **136** grante për **74** organizata të ndryshme të të drejtave të grave në 29 komuna të Kosovës, duke arritur shumën totale prej **639,326€**.

Në total, **193,637 njerëz nga vise të ndryshme** (79% gra dhe 21% burra) **përfituan** nga këto iniciativa, duke përfshirë gratë me aftësi të kufizuara, nga zonat rurale (46%) dhe nga etni të ndryshme (p.sh. gra turke, gorane, serbe, rome, ashkalie dhe egjiptiane) dhe gra të reja (34%). Përveç kësaj, këto nisma mundësuan që **3,471 gra** të mermin pjesë në politikë dhe proceset vendimmarrëse, duke përfshirë **396 iniciativa të ndryshme avokuese**. Me mbështetjen e Fondit, grupet e të drejtave të grave kanë kontribuar në **21** ndryshime të politikave drejt përmirësimit të jetës së grave, vajzave, burrave dhe djemve. Ata kanë trajtuar çështje të rëndësishme brenda komuniteteve të tyre, duke filluar nga e drejta e grave për qasje në kujdesin shëndetësor cilësor, në adresimin e dhunës në baza gjinore, në fuqizimin e grave në ekonomi dhe në rritjen e pjesëmarrjes së grave në politikë.

Të arriturat kryesore të Fondit të Grave të Kosovës

- 2,912 gra dhe vajza dhe 486 burra kanë përfituar
- 376 gra kanë marrë pjesë në procese vendimmarrëse (disa prej tyre për herë të parë)
- Janë ndërmarr gjithsej 89 iniciativa avokuese
- Shtatë politika publike kanë ndryshuar për të përkrahur më mirë nevojat e grave dhe vajzave, si rezultat i iniciativave avokuese të përfitueseve të granteve
- Disa inicativa kanë kontribuar direkt në Planin e Veprimit Gjinnor II të BE-së
- Ka rritur kapacitetin e anëtareve të RrGK-së për të planifikuar më mirë dhe për të shkruar projekt propozime. Si rezultat, 18 anëtare të RrGK-së, përfshirë edhe grupe rurale dhe të minoriteteve, kanë aplikuar dhe fituar për herë të parë mbështetje financiare nga donatorë të ndryshëm
- Kryetarë të komunave të ndryshme dhe zyrtarë për barazi gjinore janë përfshirë në iniciativat e anëtareve të RrGK-së
- Anëtarët e RrGK-së janë aftësuar për avokim përmes “qasjes së të mësuarit duke vepruar” dhe disa prej tyre kanë ndërmarrë iniciativa avokuese për herë të parë
- Anëtarët e RrGK-së ofruan bashkë-financim të konsiderueshëm për iniciativat e tyre
- Anëtarët e RrGK-së kanë fituar njohuri në krijimin dhe mirëmbajtjen e databazave për monitorim dhe vlerësim të punës së tyre

Si funksionon Fondi i Grave të Kosovës?

Fondi i Grave të Kosovës mbështet organizatat e të drejtave të grave të regjistruara si anëtare të RrGK-së.

Ideja e mbështetjes vetëm për organizatat anëtare të RrGK-së, dhe jo të gjitha organizatave të shoqërisë civile, është që së bashku anëtarët e Rjetit janë të angazhuara për të punuar drejt arritjes së objektivave të përbashkëta, të parapara në Strategjinë e RrGK-së. Ky dokument i rëndësishëm, në njëfarë mënyre, shërben si një dokument strategjik kryesor për lëvizjen e grave në Kosovë. Çdo organizatë e udhëhequr nga gratë që pajtohet me vizionin dhe misionin e RrGK-së, punon për çështje të ngjashme dhe angazhohet të ndjekë Kodin e Mirësjelljes mund të anëtarësohet në rrjet.

Aktualisht, shumica e organizatave të të drejtave të grave në Kosovë janë anëtare të rrjetit, duke arritur gjithsej në 126 organizata anëtare deri në dhjetor 2017. Fondi është i përkushtuar për të mbështetur grupet e grave në mënyrë specifike për shkak të pengesave që gratë kanë hasur historikisht në qasje për mbështetje të punës së tyre. Për të fuqizuar gratë, ne besojmë se është e rëndësishme të mbështesim gratë drejtpërsëdrejti, ndërkohë që punojmë me burrat dhe djemtë drejt një ndryshimi të gjërë transformues socio-kulturor.

Organizatat anëtare të RrGK-së inkurajohen që të dorëzojnë aplikacione për iniciativa që do të kontribuojnë në realizimin e qëllimeve strategjike të identifikuara në Planin Strategjik të RrGK-së për vitet 2015-2018. Përmes një procesi konsultativ, anëtarët e RrGK-së vetë i kanë përzgjedhur fushat më me interes për gratë. Ato përfshijnë:

- Fuqizimin e RrGK-së dhe anëtareve të saj;

- Mbështetjen e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe vendimmarrje;
- Përmirësimin e qasjes së grave në kujdes shëndetësor cilësor;
- Luftën kundër dhunës në familje; dhe
- Fuqizimin ekonomik të grave.

Organizatave anëtare mund të aplikojnë për fonde në gjuhën shqipe, serbe apo angleze duke përdorur Formën e Aplikimit që gjendet në uebfaqen e RrGK-së www.womensnetwork.org.

Për të aplikuar për grante të Fondit të Grave të Kosovës, një organizatë duhet të jetë anëtare e RrGK-së; të ndërmar iniciativa avokuese për përkrahjen dhe promovimin e të drejtave dhe interesave të grave dhe vajzave; të planifikojë dhe zbatojë aktivitete në përputhje me strategjinë e tyre organizative; të ndërmarrë aktivitete që kontribuojnë në Planin Strategjik të RrGK-së; të arrijë tek komuniteti dhe/ose personat dhe grupet e marginalizuara; dhe që u mungojnë mundësitë tjera të sigurimit të fondeve.

Komisioni Përzgjedhës për Grante i Fondit të Grave të Kosovës, i përzgjedhur në baza vjetore nga anëtarët e RrGK-së, takohet dy herë në vit për të vendosur nëse projekt-propozimet i përmbushin kriteret e lartëcekura dhe për të miratuar grantet duke përdorur një sistem të bazuar në mbledhjen e pikëve. Shuma e grantit ndryshon varësisht nga shumta e fondeve që Fondi i Grave të Kosovës ka në dispozicion. Përmes këtij projekti të financuar nga BE, organizatat anëtare të RrGK-së kanë pasur mundësinë të aplikojnë për dy lloje të granteve: Grante individuale për avokim (deri në 4,000€) dhe Grante avokimi në partneritet për ndryshim (deri në 8,000€) ku dy organizata mund të aplikojnë për një iniciativë të përbashkët.

Gjithsej, janë shpërndarë 22 grante prej të cilave 5 grante në partneritet për ndryshim dhe 17 grante avokimi individual për një organizatë.

Më shumë se vetëm një grant...

RrGK gjithashtu ofron mundësi për zhvillimin e kapaciteteve për aplikueset dhe përfitueset e granteve, për të fuqizuar organizatat tona anëtare dhe rrjetin tonë.

RrGK ofron punëtori si dhe mentorim individual në shkrimin e projekteve për grante, menaxhim të ciklit të projekteve dhe menaxhim financiar, duke kontribuar në ngritjen e kapaciteteve të organizatave për të aplikuar për fonde nga donatorë tjerë në të ardhmen.

Meqë përpiqemi të forcojmë lëvizjen e grave, ne vazhdimisht promovojmë solidaritetin mes organizatave dhe u ofrojmë mbështetje të gjitha organizatave, bazuar në nevojat e tyre.

Poashtu për organizatat të cilat nuk arrijnë të përzgjedhen për të marrë mbështetje nga Fondi në raunde të caktuara, ne përgadisim një letër me shpjegime të detajuara ku përfshihen arsyet e dhëna nga Komisioni për Shqyrtimin e Granteve. Anëtarët e stafit të RrGK-së takohen me organizatat anëtare për t'i mbështetur ato për trajtimin e çështjeve të identifikuar në këto letra, në mënyrë që ato të mund të përgatiten për të aplikuar përsëri në Fond në raundet pasuese. Andaj, qëllimi është ngritja e kapaciteteve të organizatave, duke përdorur qasjen "të mësuarit nga praktika".

“Ky fond shërben për shumë gjëra, duke filluar nga mënyra e aplikimit për një projekt të denjë e deri te raportimi.”

- Anëtare e RrGK



Stafi i RrGK mbështet organizatat anëtare për të krijuar strategji avokuese.

Mbështetja e RrGK-së për përfitueset e granteve nuk përfundon edhe pasi të jetë ndarë granti. Ne vazhdojmë të ofrojmë mentorim individual për secilën përfituese të granteve përgjatë realizimit të iniciativës së tyre dhe shpesh edhe më pas.

Kjo përfshin vizita në teren, zhvillimin e shkathtësive në menaxhim financiar, ndihmë lidhur me menaxhimin organizativ, këshillime lidhur me strategjitë efektive avokuese, lehtësimi i bashkëpunimit me zyrtarë qeveritarë dhe zgjidhjen e problemeve.

Ne po ashtu mbështesim anëtarët tona në të menduarit proaktiv lidhur me qëndrueshmërinë, që përfshinë planifikimin e iniciativave dhe përfitimin e mbështetjes në nivel të komunitetit për t'iu mundësuar që iniciativat e tyre të vazhdojnë edhe pas këtyre projekteve të shkurtra.

Për më shumë informata lidhur me Fondin e Grave të Kosovës, ju lutem vizitoni uebfagen tonë: (www.womensnetwork.org). Ekipi i RrGK-së mund t'iu ofrojë informata shtesë përmes e-mailit në grants@womensnetwork.org ose përmes telefonit në +381 (0)38 245 850.

**FUQIZIMI I
GRAVE
PËR
PJESËMARRJE
NË POLITIKË
DHE
VENDIMMA-
RRJE**

Gratë në Dragash pjesë e proceseve politike

Ndryshimet e qëndrueshme, pozitive, nuk mund të ndodhin nëse gratë nuk ushtrojnë veprimtari për jetën e tyre private dhe publike. Fuqia në vendimmarrje (në atë private dhe publike) është pjesë përbërëse e kësaj veprimtarie. Përfaqësimi i grave në nivelet vendimmarrëse në Kosovë mbetet shumë i ulët në të gjitha nivelet. Pavarësisht nga rrethanat, në komunën e Dragashit femrat po depërtojnë në sferën politike. E indinjuar nga situata, Shoqata Inicativa e Grave i fuqizoi gratë duke inkurajuar për angazhim në politikë.

Aktivistet së pari e dinin se ata duhej të identifikonin gratë dhe aleatët e mundshëm. Kështu, ato u takuan me përfaqësues të Forumeve të Grave të partive politike, Forumeve Rinore, Lobit për Barazi Gjinore, grave asambleiste të Kuvendit Komunal, studentëve dhe grave në biznes, duke vendosur partneritet dhe bashkëpunim. Më tej, SHIG avokoi te kryetari i komunës së Dragashit dhe kolegët e tij dhe u takua me drejtuesit e pesë partive politike Shqiptare, Boshnjake dhe Gorane. Ndër të tjera u ndërtua një rrjet ndër-komunal i grupeve aktive të grave nga anëtare të Lobit për Barazi Gjinore, OJQ-ve, ZKBGJ-ve, Grave Asambleiste, Grupeve Joformale të Grave, grave të biznesit dhe nxënësve nga Deçani dhe Dragashi.

Përveç kësaj, radio stacione u angazhuan për të informuar më mirë publikun dhe u organizuan punëtori. Ideja që qëndronte pas aktiviteteve të shumta ishte rritja e besimit dhe e vetëdijes së

Organizata	Shoqata Inicativa e Grave
Titulli	Koha për frymë të re politike
Shuma	3,995€
Komuna	Dragash
Periudha kohore	Dhjetor 2016 - Maj 2017
Përfituesit	187

grave dhe sidomos të të rinjve për t'u angazhuar drejtpërdrejt në politikë, por edhe për të ndryshuar mentalitetin e njerëzve që tashmë mbajnë pozita të pushtetit. Kjo qasje ka mundësuar një rrjedhje të përvojave dhe ideve gjatë kërkimit të zgjidhjeve për sfidat e përditshme me të cilat përballen gratë e Deçanit dhe Dragashit. Gratë gjithashtu u inkurajuan t'i bashkoheshin partive politike, me vlerat e të cilave ato identifikohen. SHIG vuri në dukje se gratë kishin filluar të thoshin në mënyrë më bindëse "Le t'i bashkëngitemi të gjithë politikës, mjaft kanë folur të tjerët për ne!"

Rezultatet flasin për veten e tyre. Më shumë se 36 gra dhe vajza iu bashkuan si anëtare partive politike për herë të parë. Numri i grave në listat zgjedhore të partive politike është rritur. Për më tepër, numri i grave dhe vajzave në Kryesitë e Partive Politike u rrit nga një anëtar në tetë. Ka një ndryshim në gjendjen politike që mund të ndihet në seriozitetin me të cilin merren propozimet për përfshirjen e grave nga Forumet e Grave të Partive Politike.

Ende mbesin shumë sfida, por mbetet edhe vendosmëria e grave të reja për të zmbarsur paragjykimet e shoqërisë sonë. Qasja formale në pozita me autoritet dhe në proceset vendimmarrëse mund të shihet si një hap i parë, nëse jo i mjaftueshëm, i rëndësishëm, për gratë që të kenë fuqi vendimmarrëse, një hap që gratë e Dragashit tani po ndërmarrin me besim.

Liria dhe Legjenda avokojnë për përfshirje të BPGJ-së

Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinator (BPGJ) paraqet përfshirjen e perspektivës gjinore në planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e buxhetit. BPGJ-ja ndihmon që buxhetet qeveritare dhe ekzekutimi i tyre, të jenë më të barabarta, efektive dhe transparente. Sipas Ligjit të ri për Barazi Gjinore (2015) BPGJ është detyrim ligjor për të gjitha organizatat buxhetore të nivelit qendror dhe lokal në Kosovë. Më tej, Qarkorja Buxhetore Nr. 2017/01, e shpërndarë nga Ministria e Financave në qershor të vitit 2017, specifikisht ka inkurajuar të gjitha komunat që të integrojnë BPGJ-në në dokumentet e tyre buxhetore.

Megjithatë, BPGJ është një koncept mjaft i ri, si në Kosovë ashtu edhe në vende tjera. Në fillim të vitit 2016, të pakta ishin organizatat buxhetore në Kosovë që kishin filluar të zbatonin këtë detyrim ligjor, duke përfshirë këtu edhe komunat e Vitisë dhe Gjilanit. Për këtë arsye, organizatat anëtare të RrGK-së, Qendra për Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Grave dhe Fëmijëve “Liria” në Gjilan dhe “Legjenda” në Viti, vendosën të krijonin një ekip të përbashkët me qëllim të avancimit të procesit të institucionalizimit të BPGJ-së në komunat e tyre.

“Liria” dhe “Legjenda” fillimisht organizuan takime informuese me Grupin Formal të Grave Asambleiste të Komunës së Ferizajit dhe Komunës së Kllokotit, Lobin për Barazi Gjinore

Organizata	Qendra për Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Grave dhe Fëmijëve Liria dhe Legjenda
Titulli	Ngritja e pozitës së gruas në proceset e paqebërjes dhe buxhetimi gjinor
Shuma	7,927€
Komuna	Ferizaj and Kllokot
Periudha Kohore	Nëntor 2016 - Prill 2017
Përfituesit	75

në Kosovë si dhe Drejtorët e Drejtoratëve në nivel lokal të të dy Komunave. Nga të dy komunat përfituese në këto takimeve informuese morën pjesë mbi 75 gra dhe burra.

Temat në këto takime informuese ishin kryesisht



Liria dhe Legjenda avokojnë për institucionalizimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në komunat e Ferizait dhe Kllkotit.

lidhur me hapat për integrimin e BPGJ-së në vendimmarrje, agjenda gjinore dhe raporte, hulumtimet dhe analizat të cilat duhet të ndërmerren në nivel komunal.

Rezultat i këtij bashkëpunimi ishte ngritja e vetëdijes së zyrtarëve dhe aktivistëve në këto dy komuna lidhur me BPGJ-në, atë se çfarë nënkupton ky koncept dhe mënyrën se si ta zbatojnë atë në komunat përkatëse. Gjithashtu gratë në vendimmarrje u vetëdijesuan për buxhetim gjinor, si dhe u inkurajuan të jenë pjesë e hartimit të politikave buxhetore.

Kjo paraqet një hap tjetër të rëndësishëm drejt avancimit të barazisë gjinore. Këto veprime parashikohen në Ligjin për Barazi Gjinore edhe pse deri më sot pak institucione i kanë përdorur ato. Bashkëpunimi i këtyre dy organizatave dhe avokimi i tyre drejt institucionalizimit të qëndrueshëm të BPGJ-së në komunën e Ferizajit dhe Kllkotit paraqet shembull shumë pozitiv nga i cili mund të mësojnë komunat e tjera dhe institucionet e nivelit qendror. Si rezultat i kësaj iniciative, Komuna e Ferizajit ka kryer fazën e parë të Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor pasi që ka bërë hartimin e politikave gjinore. Kjo komunë tani është në fazën e planifikimit të Kornizës Afatmesme, si dhe të analizave gjinore lidhur me papunësinë.

Gratë e verbëra avokojnë për më shumë mundësi

Personat e verbër dhe me të pamurit e dobësuar shpesh hasin në diskriminim dhe vështërsi për të realizuar të drejtat e tyre.

Komiteti i Grave të Verbëra të Kosovës (KGVK) ka punuar për një kohë të gjatë për të kontribuar në përfshirjen e tyre sociale.

Në kuadër të këtij projekti janë realizuar broshura në alfabetin e Brajlit si dhe është realizuar fushata me qëllim të ngritjes së vetëdijes në lidhje me të drejtën e personave të verbër për arsim. Në mënyrë që kërkesat e personave të verbër të adresohen, është mbajtur edhe një tryezë e rrumbullakët me asambleistët e Kuvendit Komunal të Prishtinës ku janë shprehur kërkesat e tyre e që lidhen direkt me përmirësimin e kualitetit të jetesës për ta. Disa nga kërkesat e adresuara janë: Sigurimi i pajisjeve shkollore të qasshme për personat e verbër; ofrimi i materialeve në alfabetin e Brajlit si dhe e drejta e barabartë për punësim në sektorin publik e zbatim të ligjit që iu garanton të drejtat e personave të verbër.

Ajo që është shumë e rëndësishme të përmendet është ndikimi që projekti “Më shumë mundësi për gratë e verbëra” ka pasur në diskursin publik, duke e zgjeruar kështu fushën e përfituesve përtej pjesëmarrësve direkt në projekt. Kjo gjë është arritur përmes një debati të organizuar në televizionin publik të Kosovës ku është diskutuar për aktivitetet e projektit dhe temat e trajtuara në kuadër të tij.

Organizata	Komiteti i Grave të Verbëra
Titulli	Më shumë të drejta për gratë e verbëra
Shuma	3,370€
Komuna	Prishtinë
Periudha	Qershor 2017 - Nëntor 2017
Kohore	
Përfituesit	33

Gratë e verbëra asnjëherë më parë nuk kanë pasur mundësi të takohen me përfaqësues shtetëror, prandaj një veprim i qëlluar i këtij projekti është pajtueshmëria që ato, respektivisht 23 gra dhe dhjetë burra, shumë shpejt të takohen me ministrin e Ministrisë për Arsim, Shkencë dhe Teknologji ku do të flasin për sfidat me të cilat ato përballen në përditshmëri, dhe do të parashtrojnë kërkesat e tyre për përmirësimin e kualitetit të jetës.



KGVK përfshinë gra dhe burra të verbër në avokim te Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për një edukim më cilësor.

Trupi Koordinues Ndër-Komunal dhe Ndëretnik Promovon Pjesëmarrjen e Grave në Politike

Naš Dom në partneritet me Qendrën e Grave për Zhvillim Rural (QGZHR) bashkuan forcat për të rritur kapacitetet e 21 grave nga komunat e Gjilanit, Kamenicës dhe Novobërdës në fushat e avokimit, mobilizimit të komunitetit dhe përfshirjes sociale. Gratë kanë punuar për së afërmi me anëtarët e Asamblesë Komunale për të kuptuar më mirë modelet dhe mekanizmat e pjesëmarrjes në proceset vendimmarrëse në nivel lokal dhe mënyrën më të mirë për të bërë monitorimin e zbatimit të vendimeve dhe politikave lokale të miratuara. Në këtë mënyrë, gratë janë trajnuar që jo vetëm të përkthejnë nevojat e tyre dhe të komuniteteve të tyre në avokim efektiv por, edhe si të luajnë rolin prej mbikëqyrëseve kur bëhet fjalë për mbajtjen përgjegjës të institucioneve të tyre lokale.

Ky bashkëpunim i frytshëm ndërmjet përfaqësuesve institucionalë dhe grave të ndryshme nga tri komunat ka rezultuar në krijimin e një organi koordinues joformal ndërkomunal të përbërë nga përfaqësuesit komunalë dhe organizatat Naš Dom dhe QGZHR. Kombinimi i iniciativave të qytetarëve në nivel lokal, takimet e mbajtura nën ombrellën e organit koordinues dhe lobimi i fuqishëm nga organizatat e grave është provuar të jetë i suksesshëm.

Organizata	Naš Dom, Qendra për Zhvillim Rural
Titulli	Përmirësimi i politikave lokale nga perspektiva e grave
Shuma	7,980€
Komuna	Gjilan, Kamenica and Novo Brdo
Periudha Kohore	Qershor 2017 - Dhjetor 2017
Përfituesit	68

Janë dhënë rekomandime të bazuara në dokumentet komunale të punës dhe zbatimi i tij është monitoruar nga afër. Të dy organizatat që udhëhoqën këtë projekt siguruan që kjo iniciativë të jetë e dukshme për një audiencë më të gjerë duke informuar dhe frymëzuar anëtarët e tjerë të komunitetit për t'u bërë aktiv dhe për të shprehur mendimet e tyre mbi çështjet e politikës lokale.

Gratë shqiptare dhe serbe mësojnë teknika të avokimit

Pas bashkëpunimeve të shumta ndër vite, “Dera e Hapur” dhe “Ruka Ruci” ndërmorën edhe një iniciativë të përbashkët këtë vit. Kësaj rradhe iniciativa e tyre kishte për qëllim fuqizimin e grave aktiviste shqiptare dhe serbe për të çuar përpara të drejtat e grave dhe barazinë gjinore përmes pjesëmarrjes, informative dhe mediave sociale në procese që mund të ndikojnë në vendimarrje.

Projekti u zbatua në tri fshatra të banuara nga komuniteti shqiptarë dhe tri fshatra të banuara me gra të komunitetit serb, përfshirë Hajvalinë, Bardhoshin, Slivovën (komuna e Prishtinës), Dobrotinin, Uglaren dhe Graçanicën.

Projekti pati një çasje të dyfishtë: të ofrojë njohuri lidhur me përdorimin e mjeteve digjitale tek gratë aktiviste në komunitet përmes katër punëtorive. Gratë gjatë këtyre aktivitetëve patën mundësi të mësojnë si të shkruajnë storie të suksesshme, u infomuan për sigurinë dhe privatësinë e rrjeteve sociale, aktivizmin online dhe mënyrat më të mira të përdorimit të rrjeteve sociale për aktivizëm. Ato poashtu fituan shkathësi në hartimin e politikave si dhe qasje në projekte e programe potenciale që mund të ndihmojnë komunitetet e tyre përkatëse, ku patën rast të përifojnë 18 aktiviste.


Organizata	Dera Hapur dhe Ruka Ruci
Titulli	Fuqizimi i Grave aktiviste nga komuniteti për të çuar përpara të drejtat e grave dhe barazinë gjinore përmes pjesëmarrjes, informative dhe mediave sociale
Shuma	7,955€
Komuna	Prishtinë dhe Graçanicë
Periudha Kohore	Qershor 2017 - Dhjetor 2017
Përfituesit	262

Tutje, gratë morren pjesë në punëtori ku u diskutuan format e aktivizmit, angazhimit dhe pjesëmarrjes së grave, duke përfshirë iniciativat e komunitetit, peticionet dhe dialogun publik. Ndërsa në fund, pjesëmarrëset e gjashtë fshatrave u angazhuan për të ngritur vetëdijen në komunitetet e tyre për çështjet lidhur me barazinë gjinore.

**MBROJTJA
E TË
MBIJETUARA-
VE DHE E
DREJTA E
GRAVE PËR
NJË JETË
PA DHUNË**

Bashkëpunim i ri mes #EcShlirë dhe Policisë së Kosovës

Përmes bashkëpunimit të Open Data Kosovo (ODK), Girls Coding Kosova (GCK) dhe Rrjetit të Grave të Kosovës (RrGK) në shkurt të vitit 2016 është lansuar aplikacioni raportues për ngacim seksual #EcShlirë. Krijuar nga zhvillues tw softuerit me qëllim të raportimit të ngacmimeve seksuale edhe nga telefonat e mençur, aplikacioni është shkarkuar më shumë se 1097 herë dhe numri i ngacmimeve seksuale që janë raportuar është rreth 425. Sipas raporteve 67.5% të raportimeve janë bërë nga femrat, 21.7% nga meshkuj, përderisa 10.8% kanë listuar gjininë e tyre si “të tjerë” përfshirë persona transgjinorë dhe intersex.



Me qëllim për të ngritur vetëdijën për ngacmime seksuale, organizatat mbështetëse për krijimin e aplikacionit synojnë që të përdoret për përmirësuar përgjigjen institucionale për ngacime seksuale. Ata kanë menduar që policia mund ta përdorë aplikacionin për të identifikuar dhe investiguar raporte të ngacmimeve seksuale si dhe që të krijoj masa parandaluese me të dhënat e mbledhura nga përdorimi i aplikacionit për të identifikuar zonat më të rrezikuara sipas raportimeve duke synuar që policia të shtojë sigurinë në ato pika.

Organizata	Girls Coding Kosovo (GCK)
Titulli	#EcShlirë v3.0. - Bashkëpunimi me policinë e Kosovës"
Shuma	4,000€
Komuna	Prishtinë
Periodha Kohore	Korrik 2017 – Dhjetor 2017
Përfituesit	14

Megjithatë, pas fazës fillestare të zhvillimit dhe lansimit, krijuesit e këtij aplikacioni nuk kishin fonde të mjaftushme për të avokuar tutje tek institucionet.

Andaj, GCK mori mbështetje nga Fondi i Grave të Kosovës për të avokuar tek Policia e Kosovës me qëllim të përmirsimit, bashkëpunimit dhe krijimit të mundësive për Policinë e Kosovës për të përdorur aplikacionin Ec shlrë.

Tutje, raport i RrGK mbi *Ngacmimet Seksuale në Kosovë*, ka shpalosur informata që shumë policë nuk kanë informata se çka përfshinë ngacmimi seksual sipas ligjit të Kosovës. Kjo inicativë pati për qëllim për të ngritur vetëdijën e tyre dhe për të avokuar për përmirsimin e përgjigjës së policisë.

Si pjesë e kësaj inicative, GCK, ka trajnuar pjesëtarë të stafit të Policisë së Kosovës lidhur me aplikacionin, duke përfshirë detajet e plota se si punon aplikacioni, si të nxirren të dhënat, raportet, pjesën analitike dhe hartat. Pjestarët e Policisë së Kosovës theksuan se kjo është një platformë e nevojshme për sistemin e tyre, duke e konsideruar aplikacionin si një sukses. Tashmë veç se është krijuar një marrëveshje mes organizave bashkëpunuese dhe Policisë së Kosovës ku së shpejti Policia do të ketë qasje në të dhënat e aplikacionit.

Policia zyrtarisht ka emëruar një person përgjegjës për të monitoruar rastet e ngacimeve seksuale dhe për të bashkëpunuar në këtë punë. Policia shumë shpejt do të fillojë të përdorë të dhënat nga Ec Shlrë për të investiguar ngacmimet seksuale dhe për përmirsuar parandalimin e tyre.

Ndër të tjera, GCK si pjesë të këtij projekti poashtu ka zhvilluar fushatë vetëdijesuese në rrjete sociale me fakte mbi ngacmimin seksual. Pjesë e kësaj fushate ka qenë edhe një [video promovuese](#) informative përmes së cilës deri më tani janë informuar mbi 30.000 persona.



“Psikoterapeutet në Veprim” ofron mbështetje për të mbijetuarat e dhunës seksuale

Dhuna seksuale e kryer gjatë luftës përbën krim të luftës, krim kundër njerëzimit dhe akt themelor të gjenocidit, sipas Rezolutës 1820 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara mbi Dhunën Seksuale kundër Civilëve në Konflikt. Human Rights Watch ka vlerësuar se rreth 20,000 persona janë dhunuar gjatë luftës së viteve 1998-1999 në Kosovë.

Në Kosovë shoqëria i ka izoluar dhe ka dështuar në mbështetjen e grave që pësuan nga ky krim i tmerrshëm. Si rezultat, shumë gra kanë tentuar që të vazhdojnë me jetën e tyre pa mësuar ndonjëherë se si të merren me të kaluarën e tyre në mënyrë psikologjike. Kjo rezulton në sëmundje të ndryshme të pa trajtueshme, duke përfshirë edhe trauma, fobi, humbje të dëshirës seksuale, çrregullime të ngrënies, si dhe dëmtime fizike të patrajuara. Identifikimi i grave që kanë pësuar nga krimet e tilla është qenësor për t’u ofruar ndihma e nevojshme në zhvillimin e mekanizmave përbaluese që do t’u mundësojë atyre të përballojnë dhe kalojnë me lehtësi përditshmërinë.

Duke u bazuar në këto të dhëna “Psikoterapeutet në Veprim” kanë ndërmarrë iniciativën për të identifikuar gratë që mbijetuan dhunën seksuale në regjionin e Gjilanit.

Organizata	Psikoterapeutet në Veprim
Titulli	“Fuqizimi i grave viktime të dhunës seksuale dhe torturës gjatë konfliktit në Kosovë në regjionin e Gjilanit”
Shuma	3,595€
Komuna	Gjilan
Periodha Kohore	Nëntor 2016 – Prill 2017
Përfituesit	124

Gjatë takimeve grupore dhe përmes vizitave personale, “Psikoterapeutet në Veprim” kanë arritur të identifikojnë 30 raste të grave që kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës në rajonin Gjilanit. Përtej identifikimit të të mbijetuarave dhe ofrimit të këshillave individuale nga profesionistë atyre u ofruan poashtu edhe informata mbi të drejtat e tyre ligjore. Informata mbi aprovimin e amandamentit të ligjit Nr. 04/L-054 mbi “statusin e të drejtave të martirëve, invalidëve, veteranëve, anëtarëve të UÇK-së, viktimat civile të luftës dhe familjarëve të tyre” për të njohur zyrtarisht dhe për të përfshirë statusin e viktimave civile të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Tashmë me ligj, këtyre grave në Kosovë u mundësohen pensione mujore dhe përfitime të tjera të përshkruara me ligj.

Këshilli Kombëtar për të Mbijetuarit e Dhunës Seksuale gjatë Luftës në Kosovë, i themeluar në vitin 2014 nga ish Presidentja e Kosovës, znj. Atifete Jahjaga, zhvilloi legjislacionin e nevojshëm dhe aktet nënligjore të nevojshme që krijojnë parakushtet për tu siguruar që të mbijetuarat e dhunës seksuale do të kenë qasje në përfitimet e përmendura nga ligji paraprak.

Ndër të tjera u shpërndanë edhe 800 broshura informative me qëllim të ngritjes së vetëdijes tek qytetarët e Gjilanit. “Psikoterapeutet në Veprim” poashtu avokuan me sukses tek zyrtarët e

institucioneve lokale si dhe me zyrtarët e Entit për Punësim në Komunën e Gjilanit, përmes të cilëve u punësuan 11 gra të mbijetuara të dhunës seksuale.

Ish-Presidentja e Kosovës, znj. Atifete Jahjaga, flet në një diskutim për fuqizimin e grave të mbijetuara të dhunës seksuale gjatë luftës, organizuar nga Psikoterapeutet në Veprim.



Aktivistet mbështesin të mbijetuarat e dhunës seksuale për realizuar të drejtat e tyre

Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave” (QPDG) dhe “Qendra për Promovimin e Familjes së Shëndoshë” (QPFSH), ndërmorën një inicativë të përbashkët për të fuqizuar të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Ato mbështetën të mbijetuarat për të kërkuar të drejtat e tyre ligjore. Duke pasur parasysh se Ligji nr. 04 / L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Anëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre dhe legjislacionin përkatës sekondar që është miratuar së fundi, pak të mbijetuar të dhunës seksuale kishin informata për këto ligje dhe të drejtat e tyre të parapara me ligje.

Njohja e statusit të viktimës civile të luftës për të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë është çështje që në nivel institucional vazhdon të zvarritet tash e 17 vite pas luftës. Megjithatë, “Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave” (QPDG) dhe “Qendra për Promovimin e Familjes së Shëndoshë” (QPFSH), realizuan projektin “Fuqizimi i të mbijetuarave të dhunës seksuale gjatë luftës për realizimin e të drejtave të tyre ligjore”. Këto dy organizata në partneritet përmes këtij projekti synojnë që të paktën në nivel të kompetencave të

Organizata	Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave & Qendra për Promovimin e Familjes së Shëndoshë
Titulli	“Fuqizimi i të mbijetuarave të dhunës seksuale gjatë luftës për realizimin e të drejtave ligjore”
Shuma	7,305€
Komuna	Drenas
Periudha Kohore	Korrik 2017 - Tetor 2017
Përfituesit	98

organizatave të shoqërisë civile, t'iu ofrojë ndihmën e duhur në kërkimin e të drejtave të tyre.

Opusi i përfshirjes në projekt ishte mjaft i gjerë, duke pasur kështu gjithsej 217 persona të përfshirë. Ndër ta viktimë të dhunës seksuale, familjarë të tyre, nxënës të shkollave të mesme si dhe përfaqësues nga institucionet e komunave Drenas, Skënderaj dhe Prishtinë.

Duke shfrytëzuar përvojën e mëparshme të punës me të mbijetuarat e dhunës seksuale, QPDG në bashkëpunim me QPFSH kanë zhvilluar takime me të mbijetuarat e dhunës seksuale duke iu ofruar ndihmë për procedurat e nevojshme ligjore për të marrë statusin e viktimës civile të luftës, ku janë shpjeguar rregullorja dhe formulari që duhet plotësuar në mënyrë që të fitojnë këtë status.

Gjithashtu janë mbajtur takime me familjarët e të mbijetuarave të dhunës seksuale gjatë luftës, ku është folur për rëndësinë e mbështetjes dhe mosparagjykimit ndaj të mbijetuarave, si dhe çështje ligjore që lidhen me të drejtat e tyre. Takime për të diskutuar për historitë e luftës, dhimbjen dhe krimet janë mbajtur edhe me nxënës të shkollave të mesme, formë kjo për të zgjeruar edhe më shumë ndikimin e projektit.

Pjesë tepër e rëndësishme e aktiviteteve janë edhe takimet me qëllim të ofrimit të asistencës dhe mbështetjes për të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë për plotësimin e dosjeve dhe formularëve për të përfituar statusin e viktimës civile. Nga ky aktivitet përfituese ishin gjithsej 120 gra.

Poashtu, në kuadër të projektit është bërë edhe mbledhja dhe dokumentimi i dëshmimeve të krimeve, të cilat janë gjithsej 50 dëshmi të personave që synojnë të bëjnë ndjekje penale për kryesit e krimeve dhe të cilat ruhen me fshehtësi në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Rezultati kryesor i projektit është se përmes punës së tyre QPDG ka arritur të krijojë imazhin e një hapësire të sigurtë ku të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë mund të

shkojnë, të rrëfihen e të kërkojnë ndihmë. Kjo është dëshmuar edhe nga fakti se vetëm gjatë periudhës së zbatimit të projektit, shtatë raste të reja të dhunës seksuale gjatë luftës janë paraqitur në QDPG.

Gjithashtu duhet përmendur ndikimi që projekti ka pasur tek nxënësit e shkollave të mesme, ku gjithsej 52 të rinjë të dy shkollave të mesme të komunës së Drenasit janë informuar rreth historisë së luftës dhe dëmeve që ajo ka shkaktuar. Si rezultat i takimeve disa të rinjë të Drenasit kanë shfaqur dëshirën që të krijojnë një shfaqje teatrale me temë për të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë.

**MBROJTJA E
TË DREJTAVE
TË GRAVE
PËR QASJE NË
KUJDES
CILËSOR
SHËNDETËSOR**

“Aksioni për Nëna dhe Fëmijë” vetëdijeson gratë për depresionin e pas-lindjes

Depresioni pas lindjes është një formë e depresionit, me ndjenjë të fortë të ploghshtimit që disa gra e përjetojnë pas lindjes së foshnjës. Sipas *American Psychological Association* një në shtatë gra përjeton depresion pas lindjes. Mund të fillojë nga java e parë deri në javën e tretë pas lindjes së foshnjës dhe mund të vazhdojë për një kohë më të gjatë. Manifestohet në atë mënyrë që nënat humbin interesimin për gjërat të cilat më parë kanë qenë me interes për to, kanë vështërsi në krijimin e lidhjes me foshnjën, humbin interesimin për foshnjën, për familjen dhe shoqërinë.

Fatkeqësisht për depresionin pas lindjes nuk ka shumë informata në shoqërinë tonë, andaj “Aksioni për Nëna dhe Fëmijë” ka filluar iniciativën “Avokimi për Zgjerimin e Kurrikulës Informative në Qendrat Informuese për Shëndetin e Gruas (QIShG) dhe Trajnimi i Stafit në Qendra”.

Iniciativa ka pasur qëllim avokimin në Divizionin për Shëndetin e Nënës dhe Fëmijës për përforcimin e Qendrave ekzistuese përmes zgjerimit të kurrikulës së temave që ligjërohen në Qendra, me theks në depresionin e pas-lindjes, në mënyrë që gratë dhe vajzat të marrin informacione për këtë temë shumë të rëndësishme në nivelin e kujdesit primar shëndetësor, trajnimin e stafit në Qendra, zhvillimin e videove informuese dhe

Organizata	Aksioni për Nëna dhe Fëmijë
Titulli	“Avokimi për zgjerimin e kurrikulës informative në Qendrat Informuese për shëndetin e gruas dhe trajnimi i stafit në Qendra”
Shuma	3,995€
Komuna	Prishtinë, Ferizaj, Shterpce dhe Mitrovicë Jugore
Periodha Kohore	Janar 2017 – Korrik 2017
Përfituesit	265

promovuese, dhe Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Ministrinë e Shëndetësisë për revidimin e Fletores për Shtatzëna me informacione mbi QISHG-të (p.sh. ekzistencën dhe lokacionin e Qendrave, temat që trajtohen, dobritë e këshillimit).

Përfitueset direkte të projektit, përmes ligjëratave të mbajtura në Qendra, janë gratë me kushte të vështira jetese, me nivel të ulët të arsimit, deri në analfabete, si dhe gra të deprivuara nga të drejtat e tyre, nga të gjitha komunitetet (shqiptare, serbe, rome, ashkallike, egjiptase, turke, boshnjake) në Komunën e Prishtinës, Ferizajit, Shtërpçës dhe Mitrovicës ku janë funksionale QISHG-të. Në këto Qendra janë gjithësej 19 shërbyes mjekësor të trajnuar mbi temën e depresionit pas-lindjes.



Aksioni për Nëna dhe Fëmijë trajnon infermieret dhe mamitë si ti trajtojnë gratë me depresion pas lindjes.

Pjesëmarrësit janë ndarë të kënaqur lidhur me ofrimin e këtij trajnimi, duke përmirësuar kualitetin e shërbimeve dhe komunikimin mes tyre dhe pacientëve, njëherit dhe referimin e vajzave dhe gra ve në këto Qendra, e më pas tek psikologu apo psikiatri.

Duke pasur parasysh që mund të ndodh që në disa raste depresioni pas-lindjes është pasojë e dhunës psikike në familje,

“Aksioni për Nëna dhe Fëmijë” synojnë që përmes ofrimit të informacioneve rreth gjendjes së depresionit pas-lindjes dhe trajtimit të këtyre simptomave, të ulët efekti i dhunës në baza gjinore tek vajzat dhe gratë.

Përveç trajnimeve të ofruara, “Aksioni për Nëna dhe Fëmijë” avokoi me sukses tek Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Komunën e Prizrenit që brenda saj të hapet Qendra "Klasat për Nëna" si pjesë e programeve edukative për shëndetin e nënës dhe fëmijës në Kosovë. Këto klasa ofrojnë shërbime edukative shëndetësore për vajzat, gratë si dhe partnerët e tyre duke përfshirë midis tjerash: përgatitjen për një shtatëzëni të shëndetshme, ecurinë e saj dhe procesin e lindjes, kujdesin ndaj foshnjës, rëndësinë e të ushqyerit me gji, përgatitjen psikike dhe fizike për sallën e lindjes, si dhe informacione të tjera për kujdesin dhe zhvillimin e fëmijës. Klasat ofrojnë këshilla në një ambient të këndshëm dhome dhe në mënyrë interaktive.

Të rinjët informohen për shëndetin përmes artit

Arti dhe teknikat teatrale janë përdorur si mjet për të transmetuar mesazhe në projektin për edukim të bashkëmoshatarëve të realizuar nga Qendra Artpolis dhe Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave (QPDG) në Drenas.

Projekti ka realizuar takime të ndryshme informuese, përfshirë edhe takime avokuese me vendimmarrës në nivel lokal dhe qendror, të cilët njëkohësisht edhe kanë qenë pjesë e njërit nga trajnimet për adresimin e edukimit seksual dhe shëndetit riprodhues duke përdorur teknikat teatrale.

Janë rreth 300 persona që në një formë ose tjetër janë bërë pjesë e këtyre aktiviteteve, përdërisa nëntë të rinjë nga ky grup kanë qenë edhe pjesë e shfaqjes Forum teatër “Jeta jem, Shneta jem” të krijuar nga Artpolis në kuadër të këtij projekti. Kjo ka ndodhur duke realizuar aktivitet në shënimin e ditës botërore të HIV/AIDS, ku janë përgatitur 150 broshura me informacione bazike vetëdijesuese në lidhje me të drejtat dhe shëndetin seksual e riprodhues dhe 50 çanta me logon e krijuar posaçërisht për këtë aktivitet. Këto materiale janë shpërndarë nga të rinjtë e shkollave të mesme të larta të Drenasit në sheshin kryesor të qytetit.

Organizata	Artpolis & Qendra për Promovimin e të drejtave të grave (QPDG)
Titulli	“Njohja dhe promovimi i të drejtave të shëndetit riprodhues dhe edukimi seksual përmes artit dhe angazhimit të të rinjëve”
Shuma	7,927€
Komuna	Pristina and Drenas
Periudha Kohore	Nëntor 2016 - Mars 2017
Përfituesit	300

Gjatë projektit është formuar një grup avokues me 20 të rinjë nga Komuna e Prishtinës dhe Drenasit që të drejtat e shëndetit riprodhues dhe edukimit seksual të futen brenda planprogrameve arsimore.

Takimet dhe trajnimi ka përfshirë sesione me informacione dhe ushtrime lidhur me të drejtat dhe shëndetin seksual dhe riprodhues; Seksi, gjinia dhe orientimi seksual; Edukata seksuale në kurrikulat mësimore;

Sëmundjet seksualisht të transmetueshme; Mënyrat dhe metodat e mbrojtjes nga SST dhe shtatëzania e padëshirueshme/hershme; Shëndeti seksual dhe riprodhues si temë tabu në familjet kosovare; Virgjëria në shoqërinë kosovare; dhe Avokimi.

Gjatë trajnimeve tjera është trajtuar edukimi i bazuar në Teatër. Në këtë pjesë janë dhënë informacione dhe janë zhvilluar ushtrime tjera të cilat kanë ndihmuar pjesëmarrësit të njohin më



Artpolis dhe QPDG përmes forum teatrit vetëdijesojnë të rinjtë për edukatën seksuale.

shumë veten e tyre ashtu që tutje të mund të zhvillojnë personazhet e tyre. Temat e përzgjedhura kanë qenë rreth vetëdijesimit për përkrahje dhe mirëkuptim të komunitetit LGBTQI, trajtimi i çështjes së virgjërisë dhe ndikimit të familjes në përcaktimin e jetës në çift, drogat e përdhunimit dhe sëmundjet seksualisht të transmetueshme.

Në përmbyllje është dhënë në Teatrin Dodona në Prishtinë përsëri shfaqja “Jeta jem, Shneta jem” e cila është përcjellë me diskutim me publikun.

Projekti ka arritur që te ketë më shumë të rinjë të Komunes së Drenasit dhe Prishtinës të informuar në lidhje me të drejtat e tyre shëndetësore. Njëkohësisht ka vetëdijesuar më shumë zyrtarë të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë lidhur me mosrespektimin e planprogramit shkollor nga mësime të mësimdhënës.

Instituti “Alfa” mbron të drejtat e grave të burgosura

Të drejtat e njeriut janë të drejta të garantuara me ligjet dhe me kushtetutën e Republikës së Kosovës. Këto të drejta u garantoohen të gjithë qytetarëve të Kosovës, pa marrë parasyshë statutin social e ekonomik, prejardhjen gjeografike apo përkatësinë etnike. Për më tepër, këto të drejta i takojnë edhe personave që vuajnë dënime në Institutet Korrektuese në Kosovë.

Për t'u ofruar një qasje gjithëpërfshirëse dhe mundësi të barabarta, si dhe për të kontribuar në mirëqenien e të burgosurave gra dhe vajza në kuadër të projektit “Mbrojtja e të drejtave të grave të burgosura përmes socializimit të tyre”, Instituti i Psikologjisë Aplikative “Alfa”, gjatë këtij viti ka bashkëpunuar me Institutin Korrektues në Lipjan. Përfituese të këtij projekti ishin 20 gra të burgosura të grupmoshës 18-40 vjeç, si dhe 15 oficer nga po ky Institut.

Qëllimi i këtij projekti ishte që përmes punëtorive të mbajtura mbi traumën, stresin, zemërimin, frikën, ankthin, fobiet dhe teknikat për reduktimin dhe tejkalimin e tyre, t'u mundësohet grave dhe vajzave të burgosura qasje në njohuri se si ta lehtësojnë në të ardhmen adaptimin në rrethanat stresuese të mjedisit korrektues dhe ndërtimin e formave konstruktive të komunikimit.

Organizata	Instituti Alfa
Titulli	“Mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe grave të burgosura në Kosovë përmes socializimit të tyre”
Shuma	3,985€ + 3,845€
Komuna	Lipjan
Periudha Kohore	Dhjetor 2016 – Maj 2017
Periudha Kohore	29

Gjatë fazës së dytë të projektit, Instituti “Alfa” vazhdoi punën me të burgosurat, duke u koncentruar në konceptet: faljen dhe pajtimin.

Koordinatorja e projektit, Melihate Juniku, bëri një prezantim lidhur me faljen dhe pajtimin; për rëndësinë dhe lehtësimin shpirtëror të njerëzve që falin dikë dhe që pajtohen me dikë për gabimin e bërë. “Ndonëse është mjaftë e vështirë të bindësh veten që t’i falësh dikujt një gabim, njeriu në momentin që fal dikë ndihet më i qetë, ndihet më mirë shpirtërisht. Derisa nuk e falë një person, çdo herë do e kesh në mendje, sa herë ta takosh do të kthej mbrapa edhe më shumë edhe do ta kujtoj momentin që ka ndikuar në keqësimin e raporteve tuaja”.

Përderisa falja është akt i njëanshëm, për tu arritur pajtimi duhet të jetë pëlqimi i dy njerëzve. “Të falësh është akt madhështor” u shpreh njëra nga të burgosurat.

Pas përfundimit të projektit, gratë dhe vajzat e burgosura në Institutin Korrektues në Lipjan, filluan të kenë një qasje më të mirë dhe më pozitive edhe ndaj njëra tjetrës, duke ndikuar drejtëpërsëdrejti në socializimin e tyre dhe duke kontribuar në mirëqenien e tyre të përgjithshme.



Gratë e burgosura shprehin falënderimet e tyre ndaj Institutit Alpha

Gratë në Prizren përfitojnë kontrollë pa pagesë

Në Prizren, shumë vajza rome, ashkallike dhe egjiptase e braktisin shkollën para përfundimit të arsimit të detyrueshëm, në të shumtën e rasteve për shkak të martesave të hershme. Të shqetësuar për këtë gjendje, organizata “Foleja”, vendosi të organizojë takime për diskutime për të informuar nënat, familjet dhe gratë e reja për rëndësinë e arsimit, si dhe për të siguruar informata për kujdesin shëndetësor. Ligjeratat u mbajtën në hapësirat e Qendrës e Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe në hapësirat e Institutit të Shëndetit Publik, ku përfituan 167 gra dhe 13 burra të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas. Ligjeratat u organizuan të ndara në grupe të vogla me qëllim që të kenë hapësirë të përshtatshme edhe në mënyrë që të gjithë pjesëmarrësit të kenë mundësi për pyetje e diskutime. Gjatë ligjeratave doktorëshat ofroi informata në lidhje me sëmundjet seksualisht të transmetueshme, si të shmangjet shtatzënia e padëshiruar dhe si të përdoren mjetet kontraceptive.

“Foleja” gjatë ligjeratave identifikoi pesë gra shtatzëna që asnjëherë nuk kishin shkuar të kontrollohen te gjinekologu. Falë këtyre ligjeratave ato kuptuan rëndësinë e kontrollave rutinore, e sidomos për kontrollat gjatë shtatzënisë. “Foleja” gjithashtu u mundësoi që po ato pesë gra të shkojnë në spital për kontrolla dhe analiza laboratorike, me ç’rast edhe hapën për herë të parë

Organizata	<i>Foleja</i>
Titulli	“Ngritja e nivelit të edukimit shëndetësor për rëndësinë e planifikimit familjarë dhe shëndetit reproduktiv”
Shuma	3,675€
Komuna	Prizren
Periudha	Nëntor 2016 - Gusht 2017
Kohore	
Përfituesit	313

librezat mjekësore ku do të evidentohen të gjitha kontrollat e tyre gjinekologjike në të ardhmen.

Ndër të tjera, “Foleja” avokoi me sukses tek Dr. Afrim Avdaj, Drejtor i Spitalit të Përgjithshëm në Prizren “Dr. Daut Mustafa”, që 30 gra që nuk kishin kryer asnjëherë kontrolle e analiza bazike, të mund t’i kryejnë kontrollat gjinekologjike, mamografinë dhe paptestin pa pagesë. Një grua 57 vjeçare gjatë kontrollës zbuloi se kishte një miomë në mitër. Nga intervenimi mjekësor i menjëhershëm gjithçka përfundoi me sukses.

“Unë me të vërtetë nuk kam menduar që jeta ime do mund të ishte në rrezik për shkak se nuk kam qenë në kontrollë gjinekologjike. Tash e tutje gjithmonë do të kryej kontrollet siç më ka rekomanduar doktoresha”, u shpreh ajo.

Dr. Afrim Avdaj ka premtuar që një grup i grave të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas të cilat jetojnë në kushte të vështira ekonomike do të mund të marrin shërbime shëndetësore pa pagesë, përfshirë kontrollet si pap testi, mamografia dhe analiza tjera laboratorike.

Gjatë këtij projekti janë shpërndarë 300 broshura për senzibilizimin e grave mbi shëndetin riproduktiv, të cilat janë shpërndarë edhe në gjuhën rome për gratë e komuniteteve që nuk flasin gjuhën shqipe.



Gratë në Prizren përfitojnë kontrolle pa pagesë.

ShEPF angazhohet që gratë të gëzojnë shëndet të mirë

Shëndeti i grave dhe vajzave ka qenë shqetësimi që është trajtuar nga projekti “Një femër e edukuar – shoqëri e shëndoshë” zbatuar nga “Shoqata për Edukim dhe Përkujdesjen e Familjes” (ShEPF).

Projekti ka përfshirë rreth 230 persona në qytetin e Gjakovës dhe në katër fshatra të kësaj komune. Gratë dhe vajzat e moshave 14 deri 60 vjeç kanë përfituar nga ky projekt duke u bërë pjesë e sesioneve vetëdijesuese, takimeve avokuese, tryezave të rumbullakëta dhe duke shkuar direkt në zyrat këshilluese. Gjitha aktivitetet e projektit janë përcjellë përmes planit të punës të krijuar në fillim të zbatimit të projektit nga stafi i SHEPF-së.

Në kuadër të projektit janë realizuar takime me drejtorinë e shëndetësisë, Qendrat për Punë Sociale, mjekë, dhe drejtorë të spitaleve dhe Qendrave të Mjekësisë Familjare. Janë realizuar katër takime informuese me vajza dhe nëna në fshatrat Dobrosh, Molliq, Korenicë dhe Lipovec. Përveç punëtorive të mbajtura janë dhënë informacione ku është avokuar në institucione në nivel lokal për hapjen e një zyre pranë spitalit të Gjakovës për këshillime lidhje me shëndetin seksual.

Gjatë projektit janë zhvilluar 16 punëtori vetëdijesuese. Punëtoritë janë realizuar në shkolla dhe shtëpi. Po ashtu është realizuar edhe një pyetësor për shëndetin e vajzave, gjë që ka bërë që të tregojë se sa i rëndësishëm është projekti dhe se sa

Organizata	Shoqata për Edukim dhe Përkujdesjen e Familjes
Titulli	“Një grua e edukuar, një shoqëri e shëndoshë”
Shuma	3,815€
Komuna	Gjakovë
Periodha Kohore	Qershor 2017 – Nëntor 2017
Përfituesit	237

shumë kanë nevojë vajzat për një vend ku do të mund të vizitoheshin dhe të mos paragjykoreshin. Në këtë pyetësor janë përfshirë rreth 200 vajza të moshave 13 deri në 18 vjeç dhe një numër i grave.

Projekti ka ngritur shqetësimet por edhe diskutimet se një zyre e tillë do të jetë lehtësi për shumë vajza dhe gra. Megjithatë gjatë realizimit të projektit, me ndihmën e “Medica Gjakova” është arritur që të sigurohen vizita mjekësore për tre muaj rresht, nga dy herë brenda javës.

Në fund të projektit është arritur që të realizohet edhe një tryezë e rumbullakët ku janë shpalosur rezultatet dhe rekomandimet e dala nga i gjithë projekti. Në këtë tryezë përfaqësuesit e komunës dhanë premtime se kjo zyre mund të hapet në fund të vitit 2018, pas hapjes së Qendrës së re të Mjekësisë Familjare.

Realizimi i këtij projekti ka bërë që zyrtarët institucional të jenë më të vetëdijesuar në lidhje me rëndësinë e hapjes së zyrës gjinekologjike për gratë dhe vajzat.

Ky projekt ka bërë që tashmë në çdo fshat të krijohen grupet e vogla të vajzave, të cilat më pastaj do të mbledhin grupe të vajzave tjera dhe do t'i inkurajojnë të vizitohen pa hezituar tek gjinekologu në rast nevojë, duke tejkuluar paragjykimet.



Gratë mësojnë për të drejtat e tyre për çasje në kujdes shëndetësor.

Kujdes shëndetësor më i përshtatshëm për gra dhe vajza me aftësi të kufizuara

Për një qasje më të mirë të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuar në kujdesin shëndetësor, "Handikos Mitrovica", realizoi projektin përmes të cilit ka arritur të mobilizojë personat me aftësi të kufizuara, për gra dhe vajza nga zonat urbane dhe rurale.

Përmes ligjëratave, sesioneve individuale dhe tryezave, të cilat janë realizuar nga shoqata "Handikos Mitrovica", kanë përfituar më shumë se 100 persona të cilët kanë marrë njohuri për qasje në kujdes më të mirë shëndetësor, marrjen e masave për të kërkuar kujdes shëndetësor cilësor, për ofrimin e kushteve të volitshme për të pasur një sigurim shëndetësor dhe raportimi i shkeljeve të të drejtave të grave dhe vajzave në kujdesin shëndetësor cilësor.

Përveç Mitrovicës, projekti ka përfshirë edhe qytetarët e Vushtrrisë dhe Skenderajt, duke bërë kështu që të rritet numri i përfituesve, familjarëve të personave me aftësi të kufizuar të cilët bëjnë përcjelljen e tyre dhe kanë marrë informata të duhura në lidhje me kujdesin shëndetësor.

Aktivitete tjera të projektit kanë qenë edhe organizimi i 10 sesioneve individuale në mes personit që është lajmëruar dhe dokoreshës, ku janë ofruar shërbime mjekësore të nevojshme për shëndetin riprodhues sipas nevojave të personave me aftësi të kufizuar.

Organizata	Handikos Mitrovica
Titulli	"Qasje e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuar në kujdesin shëndetësor"
Shuma	3,531€
Komuna	Mitrovicë Jugore
Periudha Kohore	Qershor 2017 - Dhjetor 2017
Përfituesit	98

Sesionet individuale janë organizuar të kombinuara, në bazë të rasteve, duke marrë parasysh që ka pasur raste të cilat kanë pasur nevojë për kontrolla gjinekologjike apo të përgjithshme që janë kryer në Spitalin Rajonal të Mitrovicës.

Në kuadër të këtij projekti është mbajtur një tryeze të rrumbullakët dhe është organizuar një fushatë vetëdijesuese, me ç'rast janë publikuar edhe materiale promovuese. Poashtu është avokuar në krijimin e një ekipi nga "Handikos Mitrovica" për të mbështetur personat me aftësi të kufizuar për raportimin e shkeljeve të të drejtave të grave dhe vajzave për kujdesin shëndetësor cilësor. Ky ekip ka avokuar edhe pas përfundimit të projektit, duke tentuar që të fuqizojë dhe udhëzojë për mbështetje për raportimin e shkeljeve të pacientit në kujdesin shëndetësor.

Nga ky projekt janë dhënë edhe një numër rekomandimesh, duke e theksuar si më të rëndësishme nevojën për edukimin shëndetësor në kuadër të planprogrameve shkollore. Po ashtu është parë e rëndësishme edhe fuqizimi i bashkëpunimit me media si ndër shtyllat kryesore të një shoqërie të cilat kanë një rol të pazëvendësueshëm në ndryshimin dhe në përmirësimin e perceptimeve dhe të koncepteve gjinore të opinionit publik për imazhin dhe rolin e gruas në shoqëri, dhe posaçërisht gruas me aftësi të kufizuar.

ShVPD mbështet personat e verbër dhe me të pamurit të dobësuar

Personat e verbër dhe ata me të pamurit e dobësuar janë ndër grupet më të marginalizuara të Kosovës, prandaj kujdesi dhe ndihma ndaj tyre është obligim i çdokujt. “Vetëdijesim rreth përkrahjes dhe mbështetjes të personave të verbër dhe personave me të pamë të dobësuar” është njëri nga iniciativat e rradhës e ndërmarë nga Shoqata e të Verbërve dhe me të Pamurit të Dobësuar (ShVPD).

Projekti i ShVPD ka pasur për qëllim që çështjen e nevojave të personave të verbër dhe me të pamurit të dobësuar ta trajtojë në nivele të ndryshme, duke organizuar aktivitete në të cilat kanë marrë pjesë dhe kanë përfituar direkt 15 përfaqësues institucionalë, 54 persona të verbër dhe me të pamur të dobësuar si dhe 50 familje të këtyre personave.

ShVPD ka organizuar pesë aktivitete kyçe në një periudhë tre mujore, ndër të cilat: takime me përfaqësues institucional, takime me udhëheqës të projektit, takime profesionale me ekspertë shëndetësorë e socialë të ofruara për personat e verbër dhe me të pamur të dobësuar, vizita familjare tek familjarët e personave të verbër dhe me të pamur të dobësuar nga ekspertë të fushave sociale e psikologjike, si dhe një tryezë përmbyllëse e aktiviteteve të organizuara.

Organizata	Shoqata e të Verbërve dhe me të Pamurit e Dobësuar
Titulli	"Vetëdijesim për përkrahje dhe mbështetje të personave të verbër dhe personave me të pamurit të dobësuar"
Shuma	3,753€
Komuna	Rahovec
Periudha Kohore	Qershor 2017 - Nëntor 2017
Përfituesit	120

Në të gjitha këto aktivitete, personat e verbër dhe me të pamur të dobësuar kanë përfituar njohuri mbi fushën e shëndetësisë, respektivisht shëndetit mendor, përdorimin efikas dhe racional të medikamenteve dhe për sëmundje të ndryshme ndaj të cilave ata rrezikohen më shumë. Nga aspekti social ata diskutuan e avokuan për mirëqenien e të verbërve, qasjen e tyre ndaj shërbimeve sociale si dhe privilegjet që Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) i parasheh për ta. Gjatë takimeve është informuar edhe për çështjet juridike, për ligjin që i mbron të drejtat e të verbërve, benefitet që sigurohen nga legjislacioni kosovar për personat e verbër e që kanë të bëjnë me lirin nga pagesa për tatime të ndryshme si dhe mbrojtja juridike falas për të verbërit.

Falë avokimit të vazhdueshëm ShVPD ka arritur të marrë mbështetje financiare nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për të realizuar aktivitete sportive me të rinjë të verbër. ShVPD ka arritur që në bashkëpunim me Komunën e Rahovecit të sigurojë librezë anëtarësie për 120 persona të verbër dhe me të pamur të dobësuar të cilët do të lirohen nga pagesa për shërbime komunale.



Personat e verbër dhe të pamur të dobësuar diskutojnë nevojat e tyre dhe përgaditën që të avokojnë në institucionet publike.

**AVANCIMI I
TË DREJTAVE
TË GRAVE PËR
QASJE NË
BURIME DHE
FUQIZIMI
EKONOMIK I
TYRE**

Gratë në Malishevë përfitojnë subvencione nga MBPZhR

Fatime Limaj nga Banja e Malishevës, mposhti kancerin, por beteja e gjatë la gjurmët e veta. Ajo që filloi si trajtim për tumor në stomak përfundoi në komplikime që i morën funksionin e njëjës këmbë. Tani ajo ka mposhtur sëmundjen, por për shkak që humbi funksionin e këmbës, humbi edhe shpresën që të gjejë punë si person me aftësi të kufizuar.

Fatimja, e cila ka tre fëmijë dhe bashkëshortin të papunë në shtëpi, duke mos pasur të ardhura tjera filloi të punojë në tokën e familjes. Ajo nuk mund të kërkonte kredi dhe as nuk dinte si të aplikonte për grante nga qeveria apo donatorët ndërkombëtarë. Ajo dëgjoi për disa takime informuese që po mbaheshin në lagjen e saj dhe vendosi të merrte pjesë, ku edhe takoi stafin e organizatës “Rona” të cilat kishin ndërmarrë inicitivën për të avokuar për fuqizimin e grave fermere në fshatrat e Malishevës.

“Rona” fillimisht organizoi takime e ligjerata ku patën rast të përfitojnë 120 gra nga pesë fshatra të komunës së Malishevës. Gratë patën rast të mësojnë se si të aplikojnë për subvencione dhe si ti përgadisnin projekt-propozimet. Poashtu gjatë trajnimeve u identifikuan edhe gra të cilat nuk ishin marrë ndonjëherë me bujqësi por ligjërueset konkluduan që ato kishin potencial për të filluar veprimtari në këtë fushë dhe ju ndihmuan për të filluar hapat e parë.

Organizata	Rona
Titulli	Avokim për fuqizimin e grave fermere në fshatrat e Malishevë
Shuma	3,972€
Komuna	Malishevë
Periudha Kohore	Nëntor 2016 - Maj 2017
Përfituesit	125

Pjesa e dytë e këtij projekti kishte të bënte me anën praktike ku pjesëmarrëset mësuuan si të punojnë tokën, si të kultivojnë dhe përpunojnë pemët dhe perimet.

Më tutje, gjatë pjesës së tretë të projektit gratë filluan aplikimet për subvencione në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR) ku dhjetë prej tyre u përzgjedhën si përfituese për atë thirrje, përderisa Fatimja dhe nëntë gra tjera poashtu arritën që produktet e tyre ti plasojnë në tregun mobil në Sheshin Zahir Pajaziti në Prishtinë, falë një avokimi të suksesshëm nga “Rona”.

Gratë përfituese të këtij projekti tashmë kanë informatat dhe njohuritë e nevojshme për të aplikuar për subvencione dhe grante në të ardhmën.



Fatima Limaj duke punuar tokën e saj, pas mbështetjes së organizatës Rona.

“Education Code” përkrah gratë sipërmarrëse

Bazuar në statistikat e nxjerra nga Agjencia për Barazi Gjinore në Zyrën e Kryeministrit rezulton se “në Kosovë çdo i nënti biznes është në pronësi të grave”. Për më tepër nga i njëjti burim del se “gratë në Kosovë janë pronare të vetëm 11% të bizneseve”.

Andaj, “Education Code” mori iniciativën për t’i ndihmuar gratë sipërmarrëse. Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti është fuqizimi ekonomik i grave kosovare sipërmarrëse dhe ngritja e kapaciteteve të tyre në biznes dhe ndërmarrësi.

Pjesë e kësaj iniciative ishin punëtoritë tri ditore, ku patën rast të përfitojnë 36 gra nga Fushë Kosova, Obiliqi dhe Graçanica të cilat kanë potencial për biznese të suksesshme dhe tashmë mirren me ndonjë formë të ‘zanatit’, siç janë punë dore, rrobaqepësi e bletari. Këto gra pretendojnë t’i zgjerojnë ato si biznes në të cilin do të mund të punësonin edhe gra tjera.

Përfitueset mësuhan si të hartojnë plane të biznesit, si të hapet një biznes, cilat janë metodat për të pasur një biznes të suksesshëm, rreziqet e mundshme, etj. Gjatë kësaj kohe disa prej grave që tashmë kishin ide të qarta, me ndihmën e “Education Code” ato hartuan dhe finalizuan planet e bizneseve të tyre.

Gjithashtu, gjatë këtij projekti përfitueset vizituan biznese ekzistuese që të mësojnë mbi veprimtaritë e tyre si dhe të dëgjojnë rrëfimet e grave se si kanë filluar ato biznese, duke

Organizata	Education Code
Titulli	“Gratë sipërmarrëse”
Shuma	3,642€
Komuna	Fushë Kosovë, Obiliq and Graçanicë
Periudha Kohore	Maj 2017 - Dhjetor 2017
Përfituesit	39

mësuar drejtpërdrejt më shumë mbi sfidat që mund t'i kenë edhe ato në fillim.

Në fund të trajnimit drejtorja e organizatës “Education Code”, Mimoza Statovci, kishte përgaditur për të pranishmet një listë në të cilën shënoheshin thirrjet që shpallen për mbështetje të grave me grante apo subvencione të ndryshme. Njëra nga të pranishmet theksoi se kishte mësuar mjaft shumë nga kjo punëtori dhe tha se “Vitin e ardhshëm do të aplikojë për subvencione tek donatorë të ndryshëm”. Po ashtu ajo theksoi se kjo punëtori e ka motivuar që të punojë më shumë edhe të mos dorëzohet përkundër refuzimeve që mund t'i marrë në fillim.

Gratë u shprehen mirënjohëse për faktin që tani e dijnë se kujt t'i drejtohen për idetë e tyre. Njëra nga gratë e cila merrej me punë dore, por nuk kishte marrë pjesë asnjëherë në panairë, madje as nuk kishte dëgjuar për to, nga stafi i Rrjetit të Grave të Kosovës (RrGK) u vu në kontakt me dy organizata të cilat po ashtu janë anëtare të RrGK-së, me qëllim që t'i ekspozojë punimet e saj në panairët e ardhëshme.

Gjithashtu në nivel qendror “Education Code” ka avokuar për përkrahje më të madhe të grave në Ministrinë e Bujqësisë Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik ku në këto dy të fundit ka arritur të nënshkruajë Memorandum Mirëkuptimi për rritjen e përkrahjes së grave në biznes përmes rritjes së numrit të konsulencave dhe trajnimeve për to.

Gratë me aftësi të kufizuara dhe lufta e tyre për të drejta të barabarta pronësore

Duke qenë se vetëm 16.7% e grave kosovare kanë nën pronësi pronë, të drejtat e barabarta pronësore vazhdojnë të jenë problem në Kosovë. Megjithatë, kjo situatë bëhet edhe më sfiduese kur është fjala për të drejtat e grave me aftësi të kufizuara, meqenëse përballen me diskriminime të shumta dhe shtypje në jetën e tyre të përditshme. Në shoqërinë kosovare, ka disa faktorë që kontribuojnë në këtë problematikë, që nga ndërgjegjësimi i ulët për gratë dhe burrat e deri te përkrahja e dobët institucionale. Megjithatë, janë pikërisht këto pabarazi dhe padrejtësi vendi ku buron fuqia dhe pasioni i këtyre grave dhe burrave. Pasioni dhe fuqia për të ndryshuar, për të ofruar zgjidhje dhe për të fuqizuar gratë në komunitetet tona. Fuqizimi i grave ka qenë pikërisht gjëja për të cilën ka kontribuar zyra e “Handikos”-it në Mitrovicë, përmes projektit “Fuqizimi i grave me aftësi të kufizuara përmes rritjes së vetëdijes për të drejtat e tyre pronësore”.

Si OJQ që ka punuar për një kohë të gjatë në terren me gratë me aftësi të kufizuara, zyra e “Handikos”-it në Mitrovicë e kuptoi se duhej ta trajtonte problemin nga kënde të ndryshme. Prandaj, ata aplikuan qasje dhe aktivitete të ndryshme. Gjatë katër muajve të projektit, ata organizuar leksione grupore për të

Organizata	Handikos Mitrovica
Titulli	“Fuqizimi i grave me aftësi të kufizuara përmes rritjes së vetëdijesimit rreth të drejtave të tyre pronësore”
Shuma	3,946€
Komuna	Mitrovicë Jugore
Periodha Kohore	Nëntor 2016 - Mars 2017
Përfituesit	146

informuar gratë dhe burrat, zhvilluan seanca individuale dhe analizuar secilin rast më vete, aty ku paraqitej nevoja. Ekipi i “Handikos”-it u dha grave këshilla dhe udhëzime lidhur me procedurat, pavarësisht nëse këto kishin të bënin me plotësim dokumentesh apo thjesht si një zyrë në derën e së cilës gratë do të mund të trokisnin dhe të dëgjoreshin.

Megjithatë, përkrahja institucionale është thelbësore për krijimin e një ndikimi të qëndrueshëm, prandaj u organizua një tryezë e rumbullakët ku u mbledhën të gjitha palët përkatëse të interesuara: përfaqësues të institucioneve publike, noterë, avokatë, përfaqësues të shoqërisë civile dhe të medias. Pas kësaj, përmes medias sociale, u zhvillua një fushatë energjike për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut, dhe u përgatitën e u shpërndanë më shumë sesa 400 fletëpalosje për të drejtat për pronë dhe trashëgimi të grave me aftësi të kufizuara në Mitrovicë.

Rasti i Elfije Kelmendit, e cila me përkrahjen e zyrës së “Handikos”-it, tashmë është në pjesën e fundit të procesit për ushtrimin dhe gëzimin e së drejtës së saj për trashëgimi, është një shembull frymëzues. Familja e Kelmendit ka rënë dakord t’i japë asaj një apartament si pjesë të trashëgimisë së saj. Përkrahja e familjes mund të luajë një rol tepër të rëndësishëm, sikurse dëshmon ky rast, por edhe siç thotë Florije Muharremi, nënë e një fëmije me aftësi të kufizuara: “Personat me aftësi të kufizuara kanë nevojë për përkrahje dhe të gjitha këto leksione nga zyra e “Handikos”-it lidhur me trashëgiminë dhe pronësinë, kanë qenë shumë të nevojshme dhe kanë ndikuar shumë në vetëdijësimin e të gjithëve, duke përfshirë këtu edhe personat me aftësi të kufizuara, por edhe ne, si anëtarët e familjes së tyre...” Në fund, më shumë sesa 100 anëtarë, gra dhe burra me aftësi të kufizuara, nga Mitrovica, Vushtrria dhe Skenderaj, u informuan për të drejtat e tyre trashëgimore dhe pronësore, ndërkohë që u analizuan dhe u shqyrtuan 10 raste individuale.

Pas suksesit që pati ky projekt, zyra e “Handikos”-it në Mitrovicë ka reflektuar lidhur me sfidat dhe shpresat për të

ardhmen. Nevoja për përkrahje të mëtejshme të qëndrueshme për këto projekte ishte një prej çështjeve kyçe që u vunë në dukje si ndryshim i qëndrueshëm, me qëllim që gratë të gëzojnë të drejtat e tyre. Për këtë duhen më shumë sesa katër muaj kohë. Megjithatë, rezultatet e projektit të tyre na bënë të arrijmë në përfundimin se kjo organizatë po shkon në drejtimin e duhur.

Partners Kosova avokon për të drejtat e grave në pronë dhe trashëgimi

Trashëgimia e grave është një prej sfidave më të mëdha me të cilat ato përballen në Kosovë. Kjo për faktin se megjithëse ligji i Republikës së Kosovës iu garanton atyre të drejtën në trashëgimi, shpeshherë kjo e drejtë iu mohohet për shkak të kontekstit tradicional patriarkal. Në jo pak raste në Kosovë gratë kanë hequr dorë nga trashëgimia e tyre për shkak të presionit nga baballarët, vëllezërit apo familjarët e bashkëshortëve të tyre.

Projekti “Avokimi i grave për të drejtat e tyre pronësore dhe ato të trashëgimisë” i zhvilluar nga “Partners Kosova”, ka trajtuar temën e trashëgimisë së grave duke zhvilluar aktivitete që kanë përfshirë edhe burrat – të cilët në të shumtën e rasteve janë ushtruesit kryesor të presionit që i bën gratë të heqin dorë nga e drejta e tyre në trashëgimi e pronë. Pra, ndër përfituesit direkt të këtij projekti kanë qenë 76 gra dhe nëntë burra nga Drenasi dhe Mamusha, ndër të cilët është e rëndësishme të përmendet pjesëmarrja e të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë.

Përgjatë zbatimit të këtij projekti janë realizuar takime koordinuese me zyrtarë për barazi gjinore të komunave përkatëse, takime këto që kanë pasur për qëllim informimin e zyrtarëve me objektivat e projektit dhe identifikimin e

Organizata	“Partners Kosova”
Titulli	"Avokimi i grave për të drejtat e tyre pronësore dhe ato të trashëgimisë"
Shuma	€3,532€
Komuna	Drenas dhe Mamushë
Periudha Kohore	Korrik 2017 – Nëntor 2017
Përfituesit	86

përzgjedhjen e grave pjesëmarrëse në projekt. Më tutje “Partners Kosova” ka organizuar takime informuese njëditore në secilën prej komunave me qëllim informimin e grave për të drejtat e tyre, me fokus të veçantë në të drejtën e tyre për pronë dhe trashëgimi. Në këto takime të përbashkëta gratë dhe të rinjtë e të dy komunave janë përgatitur si të parashtrajnë kërkesat dhe pyetjet e tyre që lidhen me trashëgiminë e pronën, e që kryesisht kanë të bëjnë me raste specifike të cenimit të së drejtës së grave në pronë. Gjithashtu janë monitoruar zyrat e ofiqarisë dhe kadastrit, me qëllim që të ndikohet direkt në institucione që merren me pronë, ku monitoruesit kanë parë nga afër se sa respektohet paraqitja e grave trashëgimtare në fletëvdekjet e trashëgimtarit dhe si i trajton ofiqari rastet kur ka fshehje të emrave të trashëgimtareve gra.

Një prej aktiviteteve më frytdhënëse dhe me ndikim direkt në parandalimin e shkeljes së të drejtës së grave në pronë është mbështetja direkte që “Partners Kosova” iu ka bërë grave në realizimin e këtyre të drejtave për regjistrim të pronës në



emrin e tyre duke i shoqëruar dhe ofruar ndihmë në takimet e tyre në drejtoinë e Kadastrit dhe Gjeodezisë.

Si rezultat i aktiviteteve të zhvilluara në kuadër të këtij projekti, 55 gra, vajza dhe të rinjë janë vetëdijesuar për të drejtat e tyre pronësore përmes prezantimeve njëditore në komunat Drenas dhe Mamushë ku përveç tjerash kanë mësuan edhe si të bëhen avokues për këtë të drejtë.

Pjesë e rëndësishme e rezultatit dhe ndikimit direkt në institucione janë tetë monitorimet që janë bërë në zyrat e Kadastrit dhe Gjeodezisë përgjatë projektit si dhe pranimi i zotimit nga Agjencioni për Ndihmë Juridike Falas që të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë të trajtohen në mënyrë të veçantë duke përjashtuar kriteret, në rast se ato paraqesin kërkesa në këtë Agjencion.

Përmirësimi i barazisë gjinore përmes transparencës institucionale

Ligji i Kosovës për Trashëgimi garanton të drejta të barabarta të grave dhe burrave për trashëgimi. Në praktikë, pak gra e ushtrojnë këtë të drejtë. Nga normat tradicionale patriarkale, mungesa e vetëdijes për boshllëqet ligjore, rezulton në paraqitjen e shumë lidhjeve të dobëta në sistem. Forcimi i këtyre lidhjeve mund të bëhet në shumë mënyra. Disa zgjedhin të punojnë me komunitetin, gratë dhe / ose burrat, të tjerë e njohin nevojën për të punuar me institucione. Në rastin e Shoqatës së Juristëve NORMA, u zgjedh kjo e fundit dhe Norma u përqendrua në “Fuqizimin e Grave përmes Rritjes së Transparencës së Institucioneve”.


NORMA vendosi të inspektoj problemin në mënyrë institucionale, nga afër, duke analizuar 184 raste të mbyllura në katër gjykata themelore në Prizren, Ferizaj, Podujevë dhe Graçanicë. Gjatë kësaj veprimtarie shumë korrespondenca u ndanë ndërmjet NORMA-s , Këshillit Gjyqësor të Kosovës, dhe Odës së Noterëve. Kjo u bë për të lejuar qasjen e NORMA-s në dosjet e rasteve, por gjithashtu shërbeu edhe si një mjet i fuqishëm i avokimit për informim dhe ngritjen e vetëdijes. Informacionet e mbledhura kërkonin më shumë thellësi, kështu që NORMA organizoi fokus grupe me gjyqtarë, noterë, zyra të

Organizata	Shoqata e Juristëve Norma
Titulli	“Fuqizimi i gruas nëpërmjet rritjes së transparencës së institucioneve”
Shuma	3,995€
Komuna	Prizren, Ferizaj, Podujevë dhe Graçanicë
Periodha Kohore	Dhjetor 2016 – Prill 2017
Përfituesit	212

shërbimit civil dhe OJQ-të për të matur perceptimet dhe qëndrimet gjithashtu. Bazuar në atë që u tha më sipër, është hartuar një raport që përmban të gjeturat dhe rekomandimet përkatëse. Raporti më pas u nda publikisht në një tryezë të rrumbullakët me akterët kryesorë. Raporti konstatoi se ka shumë vonesa në rastet e trashëgimisë dhe se ende ka nevojë për vetëdijesimin e grave dhe burrave dhe përfitimet që vijnë nga trashëgimia e barabartë.

Më tej, NORMA ka vënë në pah nevojën për të harmonizuar Ligjin për Trashëgiminë, Ligjin për Noterinë dhe Ligjin për Procedurën Kontestimore për të eliminuar çfarëdo konfuzioni dhe problemi që mund të lind. Nga kjo iniciativë kanë përfituar më shumë se 300 persona. Vetëdijesimi i përfaqësuesve të institucioneve është përmirësuar, transparenca e institucioneve është rritur dhe ndryshimet që priten në legjislacion synojnë të përmirësojnë zbatimin.

Pa dyshim, zotërimi i pronës luan një rol të rëndësishëm në forcimin e veprimtarisë së grave dhe ka hulumtime të mjaftueshme që tregojnë se kur gratë trashëgojnë pronë, kjo sjell rezultate pozitive jo vetëm për mirëqenien e tyre , por edhe të



familjeve të tyre. Nëpërmjet punës së saj, NORMA e ka theksuar këtë dhe ka treguar se hezitimi institucional

dhe normat kulturore mund dhe duhet të ndryshojnë në mënyrë që gratë të gëzojnë plotësisht të drejtat e tyre.

QKZHIM ndihmon të rinjtë e Gjakovës për punësim

Sipas të dhënave të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), thuhet se shkalla e papunësisë është shumë e lartë. Gjatë vitit 2016, 34,3% kosovarë të moshës 25 deri 34 vjeç janë identifikuar të papunë. Kjo shifër është edhe më e lartë tek komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas. Shumë të rinjë të këtyre komuniteteve përkundër sfidave të mëdha, me shumë mund e përkushtim kanë përfunduar shkollimin univerzitar mirëpo përkundër përgaditjes univerzitare nuk kanë arritur të gjejnë punë.

“Qendra e Kosovës për Zhvillim dhe Integrim Multikulturor” (QKZHIM) në Gjakovë kishte identifikuar shumë të rinjë të cilët nuk po gjenin punë, ndërmorën inicitivën të ndihmonin 30 të rinjë të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas që kishin kryer studimet univerzitare të përgaditen për tregun e punës.

Pjesëmarrësit ndoqën kurse të ndryshme. Fillimisht ata patën mundësi të mësonjë shkathtësi mbi programe të ndryshme në kompjuter si: Microsoft Office: Word, Excel dhe PowerPoint. Pastaj përfituesit ndoqën kurs intenziv në gjuhën angleze për katër muaj me rradhë. Pasi që këta të rinjë veçse kishin fituar njohuri të mira të gjuhës angleze dhe në përdorim të programeve të

Organizata	Iniciativa për Integrim të Komuniteteve
Titulli	"Fuqizimi ekonomik i të rinjve nga komunitetet joshumicë: Rom, Ashkali, Egjiptian, me fokus tek vajzat"
Shuma	3,705€
Komuna	Gjakova
Periudha	Korrik 2017 - Dhjetor 2017
Kohore	
Përfituesit	29

ndryshme kompjuterike, ata poashtu u aftësuan si të përgadisin CV, letra motivuese dhe si të realizojnë intervista pune të suksesshme.

“Pasi që i kemi kryer kurset që na ka ofruar QKZHIM mendoj se jam e kualifikuar për shumë pozita pune, dhe jam duke pritur të aplikoj,” u shpreh një përfituese pas përfundimit të programit.

QKZHIM poashtu ka avouar tek Komuna e Gjakovës që këto trajnime të vazhdojnë të ofrohen në kuadër të komunës për të rinjë të tjerë dhe ka marrë pëlqimin e tyre. Pas zgjedhjeve komunale shumë prej zyrtarëve komunal u ndërruan dhe tashmë QKZHIM është duke u takuar me zyrtarët e ri të zgjedhur për të adresuar këtë çështje.



Të rinjtë mësojnë programe kompjuterike gjatë një trajnimi interaktiv të organizuar nga QKZHIM.

Rrjeti i Grave të Kosovës

Rr. Kadri Gjata (ish Feriz Blakçori), Kati II, Nr. 8
10000 Prishtinë, Kosovë
+381 (0) 38 245 850

www.womensnetwork.org

info@womensnetwork.org

Facebook: Kosova Women's Network



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i
menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian